



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 02.03.2021

Nr: 111

VENDIM

**"PËR CAKTIMIN E ZONËS SË ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR, NR. 40, NË BASHKINË E TIRANËS, SI NJËSINË ADMINISTRATIVE PËR ZBATIMIN E PROJEKTIT PILOT PËR PROCESIN E VOTIMIT DHE NUMËRIMIT ELEKTRONIK TË VOTAVE"**

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 19, paragrafët 1, shkronja "n" dhe 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, pikën 1, të Vendimit të Komisionit Rregullator Nr. 4, datë 13.11.2020, "Për llojin dhe karakteristikat teknike që duhet të plotësojnë sistemet dhe pajisjet e votimit dhe numërimit elektronik që prokurohen dhe përdoren në zgjedhje në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar,

**V Ë R E N:**

Komisioni Rregullator me vendimin nr.04, datë 12.02.2021 "Për disa ndryshime në Vendimin nr.4, datë 13.11.2020 "Për llojin dhe karakteristikat teknike që duhet të plotësojnë sistemet dhe pajisjet e votimit dhe numërimit elektronik që prokurohen dhe përdoren në zgjedhje në Republikën e Shqipërisë" vendosi se në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021 do të zbatohet projekti pilot për procesin e votimit dhe numërimit elektronik të votave. Projekti pilot do të kryhet me anë të sistemit dhe/ose pajisjeve elektronike, në një nga Zonat e Administrimit Zgjedhor në bashkinë e Tiranës sipas përcaktimeve të këtij vendimi. Zona e Administrimit Zgjedhor duhet të ketë në juridiksion territorial të saj, jo më shumë se 55 Qendra Votimi. Përcaktimi i Zonës së Administrimit Zgjedhor ku do të zbatohet projekti pilot bëhet me akt të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Nga të dhënat e ardhura nga Kryetarët të Njësive Administrative Tiranë rezultojnë se Zonat e Administrimit Zgjedhor, të cilat janë të përbëra me jo më shumë se 55 qendra votimi janë:

- ZAZ nr. 33 e përbërë nga 52 qendra votimi
- ZAZ nr. 38 e përbërë nga 50 qendra votimi
- ZAZ nr. 40 e përbërë nga 32 qendra votimi



Data: 02.03.2021

Nr. 111

Për caktimin e ZAZ-së, nr. 38, në bashkinë e Tiranës, si njësinë administrative për zbatimin e projektit pilot për procesin e votimit dhe numërimit elektronik të votave.

Referuar faktit se ndër Zonat e Administrimit Zgjedhor të bashkisë Tiranë, në juridiksion territorial të të cilave janë jo më shumë se 55 Qendra Votimi, janë tre të tilla. Nisur dhe nga konsultimet me subjektet pjesëmarrëse në zgjedhje është gjykuar të caktohet ZAZ-ja nr. 40 si njesia administrative ku do të zbatohet projekti pilot.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, paragrafët 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

### **V E N D O S A :**

1. Të caktoj Zonën e Administrimit Zgjedhor, nr. 40, në bashkinë e Tiranës, si njësinë administrative për zbatimin e projektit pilot për procesin e votimit dhe numërimit elektronik të votave në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 (tre) ditëve në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

